

# DREJTORIA E PROGRAMEVE NDËRKOMBËTARE

## PYETJE- PËRGJIGJE TË SHPESHTA PËR PROJEKTET BILATERALE

---

### 1. Kush mund të aplikojë në thirrjet për projekt-propozime bilaterale pranë AKKSHI?

Çdo person juridik mund të aplikojë për projekt-propozime në kuadër të thirrjeve bilaterale.

### 2. Çfarë dokumentash nevojiten për aplikim në thirrjet bilaterale të AKKSHI?

- 3(tri) kopje të projekt –propozimit në shqip
- 3 (tri) kopje të projekt-propozimit në anglisht
- 3 (tri) kopje të jetëshkrimit për secilin anëtar të të dyja grupeve të kerkimit
- Shkresë përcjellese nga titullari i personit juridik

Në kopjet e projekt-propozimit nevojitet nënshkrimi i dy koordinatorëve , një për secilin grup, atë shqiptar dhe atë të huaj.

### 3. Shkresa përcjellese, në rastin e IAL-ve firmoset nga rektori apo dekani?

Përsa kohe fakulteti konsiderohet person juridik aplikimet me firmë të dekanit janë të pranueshme nga ana e AKKSHI. Duhet të merrni konfirmim nga institucioni juaj për t'u siguruar nëse nga ana e tyre janë të pranueshme gjithashtu.

### 4. Cili është sektori përgjegjës për marrëveshjet bilaterale?

Sektori i Marrëdhënieve Bilateral, pranë AKKSHI është ai i cili harton, negocion dhe sigurohet për implementimin e marrëveshjeve bilaterale me institucionet homologe në vendet e tjera.

### 5. Cilat janë afatet e aplikimit dhe frekuencat e thirrjeve?

Si hapja e thirrjeve dhe afati për kohëzgjatjen e tyre vendosen mbi bazën e marrëveshjes me institucionet homologe dhe janë të ndryshme për çdo marrëveshje.

### 6. Sa është masa e financimit vjetor për projektet bilaterale?

Masa e financimit caktohet me marrëveshje me institucionet homologe me AKKSHI dhe është e ndryshme për çdo marrëveshje.

### 7. Cilat janë institucionet që financojnë projektet bilaterale ?

Shpenzimet për kërkuesit shqiptarë zakonisht mbulohen nga AKKSHI. Shpenzimet për kërkuesit e huaj mbulohen zakonisht nga insitucioni homolog me AKKSHI. Në varësi të marrëveshjes mund të ndodhë e anasjellta. Këto detaje përcaktohen në thirrjen që AKKSHI shpall për aplikime.

#### **8. A mund të bëj pjesë të grupit të kërkimit shqiptar kërkues të huaj?**

Nëse pjesëmarrja e kërkuesve të huaj nuk prodhon kosto financiare për projektin po. Fondet publike që AKKSHI alokon për kërkim synojnë të financojnë kërkuesit shqiptarë.

#### **9. Cilat janë kostot e lejuara?**

Kostot që lidhen me mobilitetin dhe me publikimin e rezultateve të kërkimit: Bileta avioni, treni, autobusi, fatura hoteli, dieta ditore në bazë të VKM-së për udhëtimet brenda<sup>1</sup> dhe jashtë<sup>2</sup> vendit për punonjësit e administratës shtetërore, kostot e publikimit të rezultateve të kërkimit dhe të dhënave të mbledhura gjatë kërkimit.

#### **10. Cilat janë kosto janë të palejueshme?**

Kostot për pajisje dhe aparatura që lidhen me kërkimin. Aplikantët duhet të përdorin aparaturat dhe materialet ekzistuese nëpër institucionet aplikuese të të dyja palëve.

#### **11. A mund të kërkoj financim shtesë nga palë të treta?**

Po, të gjitha format e ligjshme të financimit janë të pranueshme për pjesën e kostove të cilat nuk mbulohen nga AKKSHI.

#### **12. A mund të kërkoj rialokim të fondeve në zera të ndryshëm të planit të financimit?**

Rast pas rasti mund të lejohet. Kërkesa për rialokim bëhet nga aplikanti me shkrim dhe po kështu, aprovimi ose refuzimi jepet nga AKKSHI me shkrim.

#### **13. A është raporti vjetor i domosdoshëm?**

Raporti vjetor është detyrim kontraktor, i cili buron nga udhëzimi Nr.1, datë 30.11.2017 “Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e programeve të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik ndërmjet dy vendeve” dhe gjithashtu nga kontrata ndërmjet AKKSHI dhe fituesve të projekteve bilaterale.

---

<sup>1</sup> VENDIM Nr. 997, datë 10.12.2010 PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË QENDRËS SË PUNËS, BRENDA VENDIT

<sup>2</sup> VENDIM Nr.870, datë 14.12.2011 PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË VENDIT

#### **14. A mund të aplikoj për më shumë se një fushë?**

AKKSHI rekomandon përzgjedhjen e një ushe aplikimi për shkak se Komisionet e Vlerësimit thirrjen në bazë të fushave të aplikimit. Në raste të veçanta, projekt-rpopozime që u përkasin 2 fushave prioritare të kërkimit shkencor janë pranuar dhe vlerësuar nga një grup i përzier ekspertësh të të dy fushave.

#### **15. Kush e kryen vlerësimin?**

Vlerësimi kryhet nga grupe ekspertësh, që mbajnë titullin Akademik apo Profesor. Lista e Komisioneve të Ekspertëve të Vlerësimit për palën shqiptare, në bazë të fushave miratohet nga Bordi i Administrimit të AKKSHI. Cdo komision përbëhet nga 5 ekspertë.

#### **16. Si vendosen fituesit?**

Fituesit vendosen në bazë të vlerësimit të dhënë nga Komisionet e Ekspertëve të Vlerësimit të të dyja vendeve. Një Komitet i Perbashket me përfaqësues nga dy institucionet financuese vendoset metodën me të cilën përcaktohen fituesit duke marrë për bazë vlerësimet e Ekspertëve të fushave nga të dyja vendet.

#### **17. Kur fillon financimi?**

Pas marrjes së miratimit nga Bordi i Administrimit të AKKSHI dhe nënshkrimit të kontratave me fituesit.

#### **18. A është detyrim publikimi i rezultateve të projekteve?**

Po, publikimi i rezultateve është detyrim ligjor. Rrit transparencën lidhur me projektet dhe ndalon duplikimin e kërkimeve.

#### **19. Sa është kohëzgjatja e projekteve bilaterale?**

Zakonisht projektet bilaterale zgjasin për periudha dy-vjeçare.